



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 12625 Prot

Lezhë, më 07 / 07 /2022

VENDIM

Nr. 77, Datë 06 . 07 .2022

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE ANKUES, PËR KATEGORITË DS1, DS2 DHE DS3 TË CILËVE IU ËSHTË PRANUAR ANKESA NGA KOMISIONI I ANKIMIT

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d", të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.282, datë 09.04.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", VKB nr. 76, datë 09.06.2020 "Për miratimin e masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2 dhe DS3, për banesat e demtuara nga termeti i datës 26.11.2019 në Bashkinë Lezhë", VKB nr.79, datë 25.06.2020 "Për miratimin e vertetimit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative, si dhe dokumentacionit tjetër plotësues, që vertetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vertetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e rindërtimit", VKB nr. 22, datë 14.02.2020 "Për miratimin e manualit për procedurat e përfitimit nga programet e procesit të rindërtimit për strehim", VKB nr. 80, datë 25.06.2020 "Për miratimin e udhëzuesit "Për detajimin e procedurave

për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksinit”, dhe kontratës tip për të përfituar nga grantet e rikonstruksinit”. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e listes së subjekteve ankues, për kategoritë DS1, DS2 dhe DS3 të cilëve iu është pranuar ankesa nga Komisioni i Ankimit dhe janë shpallur përfitues.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

KB.
Post 126251,
DT 12.7.22

Nr. 483/2 Prot.

Lezhë, më 08.07.2022

Lënda : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Lezhë

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Lezhë

Bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2 gërma “b”, në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 13, pika 2, neni 29, pika 1, neni 54, neni 55, pika 2 dhe 6, në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 42, pika 1, gërma “b” dhe “d”, neni 57, neni 58, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750 datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, në Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.5, datë 6.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga program i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore** të vendimit nr.77 datë 06.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e listës së subjekteve ankues për kategoritë DS1, DS2, DS3, të cilëve u është pranuar ankesa nga Komisioni i Ankimit”.

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

